EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

PËRMBLEDHJE POLITIKASH

27 QERSHOR 2014

PËRNGJITJA E NDARJES: THEMELIMI I NJË BORDI TË PËRBASHKËT PËR QYTETIN E MITROVICËS

Autorë: Adrian Zeqiri, Sanja Lazarević

Kontribues: Trim Kabashi, Ann Madsen, Carlo Giovannone, Gazmen Salijević, Dijana Hasani

Redaktor: Pieter Troch

Si përgjigje e trazirave të fundit lidhur me heqjen e barrikadës që bllokon urën kryesore mbi lumin Ibër dhe vendosjen e të ashtuquajturit "park i paqes" në vend të saj në qytetin e Mitrovicës, ECMI Kosova shpreh me ngulm zotimin e vet të vazhdueshëm për pajtim paqësor. ECMI Kosova është angazhuar për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve në Kosovë gjatë 15 vjetëve të fundit dhe mbetet e përkushtuar për të ruajtur një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe stabile shumetnike në Kosovë. Prania e organizatës në Kosovën veriore është rritë dukshëm në vitet e fundit, veçmas me themelimin e një zyre të ECMI Kosovës në veri të Mitrovicës më 2012. Kështu, ECMI Kosova është e përfshirë rëndshëm në këtë çështje dhe mbetet e zotuar që të mundohet për integrimin paqësor të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Është bërë progres i dukshëm vitin e fundit në kuptimin e ndërtimit të një marrëdhënieje konstruktive të besimit me strukturat në veri të Kosovës. Këto arritje të rëndësishme nuk duhet të prishen nga akte dhe deklarata të shthurura nga asnjë prej aktorëve të përfshirë. Kjo përmbledhje politikash prezenton një përshkrim dhe analizë të thukët të ngjarjeve dhe ofron rekomandime të qarta për të gjithë hisedarët për ndërtimin e një dialogu të strukturuar siç parashihet në "Planin Ahtisaari".

Themelimi i " parkut të paqes" dhe jehona e tij

Gjatë orëve të hershme të të mërkurës më 18 qershor, u hoq barrikada që bllokon urën kryesore mbi lumin Ibër e që lidh Mitrovicën jugore me atë veriore. Megjithatë, ajo menjëherë u zëvendësua nga ajo që po quhet "parku i paqes". Dy protesta të ndara kundër këtyre ngjarjeve u mbajtën në jug të Mitrovicës të dielën më 22 qershor. Protesta e parë, me rreth 100 protestues, u organizua nga organizata lokale të shoqërisë civile dhe mbeti paqësore. Protesta e sytë tubonte rreth 1,000 demonstrues dhe kulmoi me përleshje mes protestuesve dhe

policisë, duke rezultuar me lëndimin e 21 protestuesve, 13 oficerëve të policisë dhe 3 gazetarëve gjatë këtyre protestave. Edhe pse protestuesit nuk u përpoqën ta thyenin bllokadën policore në urë, ata megjithatë hodhën gurë mbi policët të cilët hynë ndër turmat e protestuesve. Policia reagoi me gaz lotsjellës dhe plumba gome mbi demonstruesit. Drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin Mitrovicë, Nehat Thaçi, i përshkroi protestat si "të dhunshme dhe të mirorganizuara" dhe pohoi se "sipas hetimeve preliminare të policisë, kishte edhe protestues nga pjesë të tjera të Kosovës".[1]

Në një deklaratë për shtyp që mbulonte ngjarjet, qeveria e Kosovës pohoi se "parku i paqes" do të hiqej në ditët në vijim në përputhje me ligjet e Kosovës si dhe Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, dënoi gjithë dunën dhe i nxiti qytetarët që t'u ndihmojnë autoriteteve të vendosjes së rendit për ta kryer punën e tyre. Ministri i Brendshëm i Kosovës, Bajram Rexhepi, tha se po bashkërendonte me Brukselin dhe Uashingtonin "që t'i vënë trysni Beogradit për t'i heqë barrikadat. Nëse nuk ndodh kështu, do t'i heqim ne vetë gjatë ditëve në vijim".[2] Kryetari i komunës në pjesën jugore të Mitrovicës, Agim Bahtiri, po ashtu shprehu shqetësimin e vet lidhur me situatën dhe ngulmoi që "parku i paqes" të hiqej me çdo kusht.[3]

Në anën tjetër të spektrit Kryetari i komunës në pjesën veriore, Goran Rakić, vërtetoi se vendimi për të ndërtuar një "park të paqes" mbi urë ishte marrë në konsultim me qeverinë e Serbisë dhe se ishte i vetëdijshëm "se heqja e bllokadës së rrugës është lajm shqetësues për shumicën e sërbëve në qytet".[4] Edhe ai thirri për dialog me bashkësinë shqiptare, duke pohuar: "Vetëm nëpërmjet bisedave mund të arrijmë te zgjidhja e problemit dhe prandaj populli sërb ia ka zgjatë dorën e miqësisë gjithë popullit të Kosovës dhe të Dukagjinit për të cilët qëllimi kryesor është jeta e sigurt e pa telashe për familjet e tyre".[5] Qeveria e Sërbisë reagoi menjëherë kundrejt protestave në anën jugore të urës. Drejtori i zyrës për Kosovë e Dukagjin në qeverinë e Sërbisë, Marko Djurić, dënoi demonstratat si destruktive dhe theksoi se "janë të drejtuara kundër paqes, bashkëjetesës dhe normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet popullit sërb dhe atij shqiptar ".[6]

Këto vlerësime të ndryshme pasqyrojnë teoritë kundërthënëse prapa themelimit të "parkut të paqes." Ndërkohë që barrikada e mëparshme me stiva zhavorri konsiderohej si masë e përkohshme, instalimi i strukturave të betonta si dhe plani për ndërtimin e një parku në mes të urës shihet nga shumëkush si përpjekje për ta vendosë një barrikadë të përhershme me qëllim të ndalimit të çdo lloji të transportit fizik nëpërmjet urës. Shumë pjesëtarë të komunitetit shqiptar e shohin barrikadën si provokuese, edhe nëse barrikada nuk ishte synuar drejtpërdrejt që ta acaronte situatën e bashkësisë në jug të urës. Në veri, pjesëtarë të komunitetit sërb janë të bindur se instalimi i "parkut të paqes" është dirigjuar nga Beogradi në mënyrë që bashkësia sërbe të rijë e qetë pas heqjes së paparalajmëruar të barrikadës së

[1] http://media.unmikonline.org/?p=41480
[2] ibid
[3] http://media.unmikonline.org/?p=41547
[4] http://media.unmikonline.org/?p=41480
[5] http://www.tanjug.rs/news/134736/rakic-urges-north-kosovska-mitrovica-citizens-to-stay-calm--.htm
[6] http://www.kossev.info/strana/arhiva/reakcije_na_jucerasnje_nasilne_demonstracije_u_juznoj_mitrovici/1831

zhavorrit. Për më tej, shumë njerëz në veri besojnë se parku është një tjetër zgjidhje e përkohshme që do të hiqet dikur.

Ura ishte simbol i "rezistencës" dhe "ndarjes"

Gjatë këtyre 15 vjetëve ura mbi lumin Ibër zuri të simbolizonte komunitetet dhe territoret e ndara në Kosovë. QË nga ndërhyrja e trupave të NATO-s më 1999, ura është përdorë nga krejt pak njerëz, e edhe më pak nga popullata civile në vetura. Më 2001, qeveria franceze financoi meremetimin e urës në formën që ka sot, duke ia heqë arkitekturën e vjetër socialiste. Me gjithë pamjen e re, ura asnjëherë nuk është përdorë plotësisht për qëllimin e saj parësor, pra për transportimin e njerëzve. MË 2004, një urë e re që lidhte pjesën veriore kryesisht sërbe me pjesën jugore kryesisht shqiptare shërbeu si shkëndijë që përndezi përshkallëzimin më të keq të dhunës ndëretnike në Kosovë që nga mbarimi i luftës. Civilët druajnë se me kalimin e urës vihen në shënjestër të grupeve të ndryshme që e vëzhgojnë urën . Prania e vazhdueshme e rojave të urës ka krijuar një mjedis në të cilin pak njerëz guxojnë të kalojnë urën nga frika se do të vihen në shënjestër. Prandaj popullata më parë përdor urën alternative në Mahallën e Boshnjakëve për transport dhe për komunikim.

Stivat e zhavorit që shërbyen si barrikadë qenë vënë para 3 vjetësh për 'i penguar veprimet e ndërmarra nga qeveria e Kosovës për të vendosur shërbime të doganave të Kosovës me depërtim në Kosovën veriore. Mbyllja e urës, qoftë nëpërmjet përdorimit të frikësimit dhe kërcënimeve nga grupe të ndryshme ose nëpërmjet vënies së barrierave fizike, është bërë me kohë simbol i ndarjes ndërmjet komuniteteve shqiptare e sërbe që jetojnë në anë të ndryshme të urës. Janë dy narrative kundërthënëse në nivel të bashkësive që e dominojnë imazhin e stërpolitizuar të urës së barrikaduar. Sipas shqiptarëve, sërbët kanë vënë barrikada për ta ndaluar çdo lloj qarkullimi, për t'i penguar ish-banorët e pjesës veriore që të mos kthehen në shpitë e veta në veri, si dhe për ta copëtuar përgjithmonë Kosovën. Për sërbët në veri, barriera përfaqëson një mekanizëm të vetëmbrojtjes ku rojat e urës e ruajnë komunitetin sërb kundër sulmeve prej shqiptarëve nga jugu dhe kështu ndalojnë shpërnguljen përfundimtare të sërbëve nga Kosova. Prandaj është e lehtë me pa se vendosja e barrikadave të reja mbi urë si dhe tensionet shoqëruese i nxisin dhe rikonfirmojnë frikët e bashkësive nga të dyja anët dhe gjenerojnë keqkuptime e keqkomunikime. Vërtet, ndërsa bashkësia shqiptare zemërohet nga ajo që e konsideron si provokim serioz nga ana sërbe në përpjekje për ta bërë të përhershme ndarjen e Kosovës, dhe të qytetit të Mitrovicës në veçanti, bashkësia sërbe që jeton në veri tërhiqet në izolim kundrejt asaj që sheh si agresion shqiptar kundër një akti të drejtë të vetëmbrojtjes.

"Parku i paqes": një hap prapa

Strukturat e betonta që janë ngritur mbi urë do të vazhdojnë të ushqejnë pabesinë dhe dyshimet ndërmjet bashkësive në të dyja anët e lumit. Këto zhvillime paraqesin një pengesë të konsiderueshme ndaj përparimit të kohëve të fundit që është bërë brenda kornizës së dialogut të Brukselit. Si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit, janë themeluar autoritetet lokale komunale në veri të Kosovës dhe dalja në votime e votuesve në zgjedhjet lokale dhe ato qendrore është rritë dukshëm. Në këtë kontekst, veprimet drejt ndalimit të përhershëm të komunikimit në urë

janë një hap i dukshëm prapa, që e kthejnë kohën në gjendjen para Marrëveshjes së Brukselit dhe zgjedhjeve komunale dhe e pengojnë normalizimin e gjendjes si dhe ndërtimin e besimit ndërmjet dy komuniteteve.

Siç u tha më lart, "parku i paqes" menjëherë provokoi një reagim agresiv nga ana shqiptare e lumit, duke e nisur kështu rrethin vicioz të mosbesimit dhe moskomunikimit mes komuniteteve në dy anët e urës. Për më tej, është e domosdoshme të theksohet se sërbët që jetojnë në jug të lumit Ibër, e që përbëjnë shumicën e sërbëve që jetojnë në Kosovë, janë shpesh viktima të mllefit dhe smirës që krijohet nga kjo gjendje armiqësore. Së fundi, themelimi i këtij parku e pengon vullnetin e autoriteteve kosovare për t'u përfshirë në mënyrë kuptimplote në ushtrimin dhe zbatimin e të drejtave të komuniteteve. Shumë programe të komuniteteve dhe përpjekje që janë vënë nga qeveria e Kosovës rrezikojnë të humbin përkrahjen e qeverisë nëse kjo gjendje vijon të përshkallëzohet.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto efekte, ECMI Kosova konkludon se ngritja e barrikadave, qoftë edhe kur këto vijnë në formën e "parkut të paqes" në mes të urës, nuk përfaqëson një shteg konstruktiv drejt riintegrimit të komuniteteve të përçara në qytet dhe në përgjithësi në shtet. Pajtimi mund të arrihet vetëm duke i hapur të gjitha rrugët dhe duke e intensifikuar komunikimin ndërmjet të dyja anëve të urës, autoriteteve lokale në veri të lumit Ibër dhe autoriteteve në Prishtinë.

Zhvillimi i një dialogu të strukturuar ndërmjet të dyja anëve të qytetit/qyteteve si dhe heqja graduale e të gjitha barrikadave, duke përfshirë "parkun e paqes"

ECMI Kosova u bën thirrje autoriteteve në Prishtinë, autoriteteve lokale në komunat në veri dhe jug të Mitrovicës, qeverisë sërbe, Be-së si dhe ShBA-së që të vazhdojnë me dialogun e ndërsjellë me qëllimin e heqjes së barrikadave dhe lejimin për hapjen graduale të urës për komunikim dhe transport. Frikët e të gjitha komuniteteve duhet të adresohen nëpërmjet dialogut të hapur në të gjitha nivelet, duke i përfshirë autoritetet komunale dhe shoqërinë civile. Shqetësimi i komunitetit sërb në veri duhet marrë parasysh, meqë ky komunitet po e sheh veten veçanërisht të ndjeshëm ndaj efekteve të hapjes së pakufizuar të urës për transport mallrash e personash.

Zgjedhjet ne veri si dhe zgjedhja e një asambleje komunale dhe kryetari legjitim ishin momente kthesë për integrimin dhe dialogun me pjesën tjetër të Kosovës, duke e përfshirë Qeverinë e Kosovës. Kryetari komunal Rakić si dhe asambleja komunale në Mitrovicën veriore kanë të drejtën legjitime që të punojnë për promovimin dhe interesat e qytetarëve që përfaqësojnë. Ata këtë duhet ta bëjnë, megjithatë, brenda kufijve të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve përkatëse që garantojnë lirinë e lëvizjes dhe të shoqërizimit. Vendosja e "parkut të paqes" i pengon të drejtat e qytetarëve në të dyja pjesët e qytetit që të udhëtojnë lirshëm përsipër lumit. Kryetari Rakić dhe Kryetari Bahtiri nga Mitrovica jugore kanë dhënë të dy betimin për detyrën, duke u zotuar se do të punojnë për përmirësimin e komunave që drejtojnë, krejt kjo në interes të qytetarëve që përfaqësojnë. Kjo përfshin, *inter alia*, lirinë e lëvizjes dhe zhvillimin ekonomik. Qyteti —ndonëse i ndarë në dy administrata— është i lidhur detyrimisht nëpërmjet historisë dhe realiteteve fizike. Ura do të duhej të ishte pikë bashkimi,

jo vijë ndarëse. Ideja për ndërtimin e parkut të paqes është e mirëpritur, por një "park i paqes" që e ndan qytetin nuk është zgjidhje dhe nuk do t'u ndihmojë qytetarëve nga asnjëra anë e urës me jetën e përditshme. Duhen bërë hapa gradualë për të mundësuar heqjen e këtij "parku të paqes" me qëllimin e fundmë zhvillimin ekonomik e social për qytetarët e pjesës jugore e veriore të qytetit.

Në nivel më të gjerë dhemb afatgjatë, tensionet e tanishme do të duhej t'i inkurajonin të gjithë aktorët, edhe komunat lokale edhe Qeverinë e Kosovës në veçanti, që të themelojnë një mekanizëm për dialog të strukturuar ndërmjet dy komunave dhe komuniteteve në Mitrovicë. Ndonëse mund të sjellë pak përkrahje politike në afat të shkurtër, heqja e ngutshme dhe e pakoordinuar e "parkut të paqes" nuk do të sjellë stabilitet të qëndrueshëm ose besim ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e lumit Ibër dhe institucionet qendrore të Kosovës. I harruar prej kohësh nga të dyja anët, duke e përfshirë Qeverinë e Kosovës, "Plani i Ahtisaarit" si dhe legjislacioni përkatës i Kosovës parasheh që qyteti i Mitrovicës të ketë dy administrata që, megjithatë, do të bashkëpunojnë në fushat e kompetencave të tyre nën ombrellën e një Bordi të Përbashkët. Ligji parasheh themelimin "me kohë" të një Bordi pas themelimit të asambleve komunale në të dyja komunat e Mitrovicës.[7] Marrëveshja e Brukselit po ashtu parasheh që zhvillimi dhe integrimi gradual i veriut në kornizën e Kosovës të bëhen në përputhje me legjislacionin e Kosovës.[8] Pas zgjedhjeve dhe themelimit të asambleve komunale dhe kryetarëve legjitimë në të dyja komunat e Mitrovicës, janë pjekur kushtet për hapa të mëtejmë drejt ndërtimit të mirëbesimit mes komuniteteve të ndara shqiptare e sërbe në Mitrovicë dhe riintegrimit të komunave me shumicë sërbe në veri brenda kornizës së Kosovës. Bordi i Përbashkët mund të luaj rol kyç për uljen e tensioneve dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë ndërmjet dy kryetarëve komunale dhe dy administratave komunale. Bordi do të mundësonte që këto çështje të trajtoheshin në nivel lokal, nga këshillat e qytetit, duke e shmangur kështu mbipolitizimin e çështjes.

Në një raport të zgjedhjeve qendrore më 8 qershor 2014, ECMI Kosova ka vënë në dukje angazhimet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës dhe BE-ja për të përkrahë zhvillimin e komunave me shumicë sërbe në veri.[9] Qeveria e Kosovës ka shpallë krijimin e një "Fondi për Veriun" që do të financohet nga burime të ndryshme, duke i përfshirë taksat dhe doganat që paguhen në veri. Që atëherë, nuk janë bërë hapa konkretë dhe nuk është financuar asnjë projekt nga ky fond. Komisioni Europian ka miratuar një pako prej 38.5 milion euro për zhvillimin e projekteve në veri dhe pjesën tjetër të Kosovës.[10] Këto fonde mund ta shtojnë dukshëm zbatimin e një vargu të masave të ndërtimit të besimit për riintegrimin e komunave në Mitrovicë veri dhe Mitrovicë jug dhe mund ta përnxisë punën dhe funksionimin e Bordit të

[7] Këshilli i Sigurimit i kombeve të Bashkuara, 'Propozim Gjithëpërfshirës për Zgjdhjen e Statusit të Kosovës' (2007), aneksi III, neni 13. Gjendet online, http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf. Kuvendi i Kosovës, 'Ligji për Kufijtë Administrativë Komunalë' (Ligji nr 03/L-041), neni. 7 dhe 8. Gjendet online, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_en.pdf.

[8] http://www.rts.rs/upload/storyBoxFileData/2013/04/20/3224318/Originalni%20tekst%20Predloga%20sporazuma.pdf.

[9] ECMI Kosova, 'Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë: Vështrim i Çështjeve, Sfidave dhe Skenës Politike para Votimeve më 8 qershor'. Gjendet online: http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Information-Bulletin-Minority-Party-Elections-ENG.pdf.

[10] http://www.neurope.eu/article/385-million-euros-support-normalization-between-serbia-and-kosovo.

Përbashkët. Për këtë qëllim, financimi duhet të ndërlidhet me vendosjen e një dialogu të strukturuar ndërmjet komunave Mitrovicë veri dhe Mitrovicë jug, në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit.

REKOMANDIME

ECMI Kosova bën rekomandimet e mëposhtme për Qeverinë e Kosovës, Qeverinë e Sërbisë, si dhe autoritetet komunale në Mitrovicën veriore dhe Mitrovicën jugore:

(1) Të aranzhojnë një **varg të masave për ndërtimin e besimit ndërmjet dy komuniteteve, duke e përfshirë edhe heqjen graduale të "parkut të paqes**". Këto masa duhen marrë në frymën e dialogut të hapur ndërmjet autoriteteve qendrore e lokale dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Masat duhet të japin garancinë se marrin parasysh frikët e komunitetit sërb në Mitrovicën veriore, meqë ata e shohin veten si tejet të ndjeshëm ndaj efekteve të hapjes së pakufizuar të urës për transport mallrash e njerëzish..

(2) Të dalin shpejt me një **strategji dhe plan pune për themelimin e Bordit të Përbashkët për komunat në Mitrovicë veri dhe Mitrovicë jug**. Bordi do të shërbejë si një mekanizëm për ndërtimin e besimit për një dialog të strukturuar ndërmjet të dyja administratave të Mitrovicës.

(3) Të ndërlidhin drejtpërdrejt dhe tërthorazi **fondet qeveritare dhe ato nga BE për zhvillimin e veriut me themelimin e një dialogu të strukturuar** ndërmjet komunave në Mitrovicë veri dhe Mitrovicë jug, në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit.

Rreth ECMI Kosova

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e përfshirë në çështje minoritare në Kosovë, me qëllim të gjithëmbarshëm që të zhvillojë institucione gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, të ndjeshme ndaj komuniteteve e që përkrahin një Kosovë stabile shumetnike. ECMI Kosova kontribuon për zhvillimin, fuqizimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që punojnë me komunitetet, dhe shton kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u përfshirë me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.